



VENDIM

Nr. 80, Datë 23. 10. 2009

PËR

**MIRATIMIN E MODELIT TE KONTRATËS SË SHITBLERJES SË
ENERGJISË ELEKTRIKE NDËRMJET KESH SH.A. (FPSH) DHE
PRODHUESVE TË VEGJËL TË ENERGJISË (PVE)**

Në mbështetje të nenit 9, të Ligjit Nr. 9072, datë 22.05.2003, “Për Sektorin e Energjisë Elektrike”, të ndryshuar, pikës 4.13 gërma “a” pika 5, të Modelit të Tregut të Energjisë Elektrike, pikës “V” të Rregullave të Tregut Shqiptar të Energjisë, miratuar me Vendimin e Bordit të Komisionerëve nr. 68, datë 23.06.2008, nenit 25, të Rregullave të Praktikës dhe Procedurave të ERE-s, Bordi i Komisionerëve të Entit Rregullator të Energjisë (E.R.E), në mbledhjen e tij të datës 23.10.2009, pasi shqyrtoi Modelin e Kontratës “Për shitblerjen e energjisë elektrike ndermjet KESH Sh.a. (FPSH) dhe Prodhuesve te Vegjël të Energjisë (PVE)”, te paraqitur nga Grupi i Punes,

Vendosi :

1. Miratimin e Modelit te Kontratës së Shitblerjes së Energjisë Elektrike ndermjet KESH Sh.a. (FPSH) dhe Prodhuesve te Vegjël të Energjisë (PVE). (Kontrata bashkelidhur ketij Vendimi).
2. Cdo kontrate e lidhur midis KESH Sh.a. (FPSH) dhe Prodhuesve te Vegjël të Energjisë (PVE) para hyrjes ne fuqi te ketij vendimi, do te jete ne fuqi deri ne momentin e perfundimit te afatit te saj.
3. Ngarkohet Drejtoria e Licensimit dhe Monitorimit të Tregut për njoftimin e palëve.

Ky vendim hyn ne fuqi menjehere.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.